



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Na. 6685/ Prot
Dt. 20.11.2024

Nr.757/1prot.

Shkodër, më 20.11.2024

LËNDA: Mbi vendimin Nr.80 datë 30.10.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes.

KËSHILLIT TË BASHKISË VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin” i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, në mbështetje të nenit 27/2, neni 36 pika 1 germa a, neni 64/c, neni 54/e/1, neni 55/3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. I, Kap III pika 1/c të VKM Nr.54 datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyres së dhënies me qera enfitozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Finanace dhe Ekonomisë Nr.13 datë 26.04.2008 Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.54 date 5.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyres së dhënies me qera enfitozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, Çertifikatës të Regjistrimit të Pronës me Nr.546/4, ZK.3506.(Kod Unik Nr.3506008103) të Kartelës së Pasurisë së pasurisë së paluajtshme, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari Këshillit Bashkiak Vau-Dejes Nr.6679.prot datë 4.11.2024”, analizoi VKB Vau-Dejes Nr.80 datë 30.10.2024 Rishqyrtim i VKB Vau-Dejes Nr.69 datë 27.09.2024 “Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit, afat deri në 10-vjet, të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë Nr.546/4, ZK. Nr.3506, e llojit “pa fryt”, fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau-Dejes”.

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 80 Datë 30.10.2024

“Rishqyrtim i vendimit nr 69, datë 27.09.2024, të Këshillit Bashkiak, “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës. Ndryshim i përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës”.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 546/4, Zk 3506, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit nr 07, datë 24.10.2024, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritet dhe Aseteve, ku kërkohet rishqyrtimi i Vkb-së nr 69, datë 27.09.2024, dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, të një pjesë të pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, lloji “Pa fryt”, “Për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit”, pas rishqyrtimit, diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. “Miratimin në parim “Dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, sipas plan rievimit bashkëlidhur, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës”. Ndryshimin e përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës, nga: “Fusha e përdorimit të pronës të jetë për veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit” që ishte në projekt vendimin e mëparshëm, në: “Fusha e përdorimit të pronës të jetë për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E VAU DEJËS

2.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritit dhe Aseteve, si dhe administrata e Bashkisë.

3.Pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut Shkodër, do vazhdohet me procedurat standarde të konkurimit publik, me të gjithë elementët e saj përbërës, sipas VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014.....”, dhe më pas me lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).



Kryetar i Këshillit
Ervis Shimaj

Sekretar i Këshillit
Ardian Çelepija

Miratuar me 20 vota

Vota pro 20

Vota kundër —

Vota abstenim —

Zbardhur me datë 04 . 11 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETJEVE
SEKTORI I ASETJEVE

PROJEKT VENDIM

Nr 7 Datë 24.10 2024

“Rishqyrtim i vendimit nr 69, datë 27.09.2024, të Këshillit Bashkiak, “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës. Ndryshim i përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe në Çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 546/4, Zk 3506, objekt i dhënies me qira, lëshuar me datë 12.01.2023, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

VENDOSI :

1. “Miratimin në parim “Dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, sipas plan rilevimit bashkëlidhur, e llojit “Pa fryt”, ndodhur në fshatin Stajkë, pronë e Bashkisë Vau Dejës”. Ndryshimin e përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës, nga: **“Fusha e përdorimit të pronës të jetë për veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit”** në: **“Fusha e përdorimit të pronës të jetë për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit”**,
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.

3. Tarifa e qirasë vjetore, afati, si dhe procedura e dhënies në përdorim do jetë me anë të konkurimit, me të gjithë elementet e saj përbërës, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për përcaktimin e kriterëve, të procedurës.....”.(sipërshkruar).

HARTOI PROJEKT VENDIMIN

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETIVE

Konceptoi: Denada Dodaj

Pranoi: P/sek. Ndoc Baqli

Miratoi: Drejtori Marinela Deda

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE
Sektori i Aseteve

RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISE SHTETËRORE E LLOJIT "PA FRYT" ME
SIPËRFAQE PREJ 1 HA NË FSHATIN STAJKË, BASHKIA VAU DEJËS

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe ruajtjen e tokave dhe kategorive të tjera të resurseve si toka të pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në administrim të saj.

Duhet t'ju sjellim në vëmendje se dhënia në përdorim me anë të konkurimit të tretëve, përveçse ka si objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, ndikon edhe në hapjen e vendeve të reja të punës, me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Nga ana tjetër, dhënia në përdorim me kontratë qiraje në rastin e tokave të pafrytshme si toka cilësisht të dobëta të cilat në shumicën e rasteve janë të shtrira në terrene të deformuara, gjithashtu jep efekte pozitive sepse e zhvillon pronën, përmirëson strukturën e saj, rregullon parametrat optimal duke e bërë më miqësore me mjedisin, si dhe duke rritur gjelbërimin e zonës.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore", ndryshuar, bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në administrim të saj, me kontratë qiraje, duke zhvilluar procedurën përkatëse të konkurimit me të gjithë elementët përbërës të saj, dhe në transparencë të plotë, sipas legjislacionit në fuqi.

Bazuar në certifikatën e pronësisë lëshuar nga DV ASHK Shkodër, pasuria nr 546/4, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, që propozohet të jepet në përdorim rezulton si pasuri e llojit "Pa fryt", e cila futet në grupin e tokave cilësisht të dobëta.

Bazuar në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014 (sipërcituar), kategoria e tokave të llojit "Pa fryt", mund të jepen në përdorim për qëllime blegtorale dhe agropërpunimi, sipas plan biznesit të paraqitur nga subjekti i interesuar, i cili rezulton fitues pas kryerjes së procedurave konkurruese, me të gjithë elementët e saj përbërës.

Vlera dysheme e qirasë vjetore për fillimin e konkurimit, do jetë sipas pikës 34, të Udhëzimit nr 13, datë 18.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014....." (sipërshkruar), ku përcaktohet se për tokat e pafrytshme, qiraja nuk mund të jetë më e ulët se 27 000 leke/ha në vit.

Për sipërfaqen prej 1 ha, çmimi dysheme i qirasë është: 1 x 27 000 = 27 000 lekë/vit.

Pas miratimit në KB dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe më pas me procedurën e konkurimit me të gjithë elementët e saj përbërës, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Duke ju falenderuar.

Hartuesit e relacionit


Ndoc Baqli



Arjeta Garubi



Denada Dodaj



KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA VAU - DEJES	K567050070	1/1

Numri i Pasurisë	546/4		
Kodi Unik	3506008103		
Zona Kadastrale	3506		
Lloji i Pasurisë	Pa frut		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 218444	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	SHKODER, STAJKE, Rr.: STAJKE		

DREJTORI
Lela Berdica

Lela
Berdica

Digitally signed by:
Lela Berdica
Date: 2023.01.12
02:06:14 +02'00'

Data e lëshimit 12/01/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtorja
Vendore Shkodër
Date: 2023/01/12 11:32:50 +02'00'
K5670500702023011211324353L1014



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedurë automatike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 3506

KODI UNIK: _____

NUMRI PASURISË :546/4

INDEX I HARTËS:K-34-76-(4-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3506008103
(Nga 3506007148 , Në)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3506 , Lloji i Pasurisë: Pa frut , Nr. i Pasurisë: 546/4 , Sipërfaqja Totale 218444 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale k-34-76-(4-c) , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia STAJKE , Rruga STAJKE , Ndërtesa Nr. , SH/K , Apartamenti Nr.

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 246 , Dt. 31/03/2011), Rivlerësim (Akti Nr. , Dt.)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA VAU - DEJES , Nr. Identifikimi/NIPT K567050070 , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia VAU DEJES , Rruga LAÇ (VAU-DEJES) , Ndërtesa Nr. , SH/K , Apartamenti Nr.

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit) , Nr. 246 , Datë: 31/03/2011

Regjistruar: Nr. 01095 , Datë: 09/01/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. , me Kod Unik*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: , Nr. , Datë:

Përshkrimi i Objektivit të Aktit:

Regjistruar: Nr. , Datë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: , Emërtimi i Aktit: , Nr. , Datë: .

Regjistruar: Nr. , Datë: .

Përshkrimi: SHKODER, STAJKE, Rr.: STAJKE

DREJTORI
Lela Berdica

Kejda
Selmani

Digitally signed by
Kejda Selmani
Date: 2023.01.12
11:32:28 +02'00'

Lela
Berdica

Digitally signed by:
Lela Berdica
Date: 2023.01.12
02:05:53 +02'00'

Data e lëshimit 12/01/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2023/01/12 11:29:45 +02'00'
K56705007O2023011211293905ASHK

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

PLAN RILEVIM

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Liçensa Nr. T.0675/2 Dt. 10.04.2018

ING. TOPOGRAF
HAMID ÇULIQ
07 LICENSA T.0675

STOTALE= 10 000 m²

546/4-S1= 2040 m²

546/4-S2= 7960 m²

Vula / Firma

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3506

NR.PASURISE 546/4 VOL _____ FQ _____

SHKALLA 1:2500

INDEKSI I HARTES K-34-76-(4-A.C)

ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER STAJKE _____

PRONARI/ET : BASHKIA VAU DEJES

